

Nr. _____ prot.

Vorë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL – Procedurë e Hapur e thjeshtuar - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje detergjente per pastrim dhe dezinfektim, Bashkia Vore”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Fshesa, fuqja dhe artikuj të tjerë te ndryshëm - 39224000-8, Kova - 39224330-0, Kosha mbeturinash - 39224340-3, Detergjentë – 39831200-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 000 000 (dy million) Leke pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 e 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të

miratuar” , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e mëposhtme:

- **ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Çertifikata e mesiperme duhet të jete e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.3.3 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklarate që merr persiper, me mjetet e veta, transportin e mallrave objekt prokurimi, në ambientet e AK, nga nënshkrimi i kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklarate për skadencën e mallrave, e cila duhet të jete jo më pak se 1 (një) vit nga momenti i levrimit të mallit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor, për këtë procedurë prokurimi mjaftohet me një deklaratë nga operatori ekonomik për të konfirmuar marrjen persiper të transportit të mallrave objekt prokurimi në kohë dhe sasi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Fshesa furce- Fshese për pastrimin e ambienteve të jashtme dhe të brendshme. Të jete me bazament plastik, me fije të dendura dhe të buta. Fshesa të jete shumë rezistente dhe me fileto për montimin e shkopit.

Kove shtrydhese- Kove plastike me pajisjen e shtrydhese, funksionale për të gjitha llojet e larjes. Permasat 40 x30x12. Kapaciteti min 15 litra.

Bishta fshese- Bishti të jete prej materialit plastik ose metali prej veshje plastike. Fileto e bishtit të perputhet me filetimin e shtupes dhe të fsheses. Gjerësia e bishtit jo më e vogël se 120 cm.

Lecka për dysheme mikrofiber- Pecete mikrofiber me fileto për montimin e bishtit, përdoret për pastrimin e dyshemese. Permasa 50x 40 cm.

Bishta për lecka- Bishta për lecka material plastik ose metalik me veshje plastike. Fileto e bishtit të perputhet me fileton e leckes.

Acid- Të jete çilesor, të ketë efekt të të lart pastrues. Të jete i ambalazhuar në bidon plastik 1-4 liter. Të jete i gjat, shumë i përqendruar dhe me një formulë shumë efektive në heqjen e papastertise dhe njollave apo mikrobeve. Të mos mbaje aromë të fortë dhe mos të demtojë lekuren e njeriut. Të jete i lehtë në shpëlarje me ujë. Afati skadences të jete jo më pak se 12 muaj nga marrja në dorezim.

Ace- Detergjent Ace të jete viskoze dhe me paketim 1-4 liter.

Ilac për xhama – Pastrues i lëngët për xhama me sprucim dhe sipërfaqe të lëmuara .Përbërja: < 5% surfaktantë atmosferikë , surfaktantë jonike. Përmban gjithashtu : parfum . Biodegradueshmeria mbi 90% të mos lërë gjurmë pas larjes. Te jete I perdorshem me te gjitha llojet e fibrave te tekstilit.Te japi nje shkelqim xhamit dhe te thahet shpejte.

Peceta pluhërash mikrofibër. Peceta mikrofibër përdoret për pastrimin e pluhërave me permasa 50x40 cm.

Doreza nje perdorimeshe pa puder masa M dhe L pako me 100 cope- Të jenë rezistente për përdorimin për larje muri e pllakash me masa M dhe L. Të jene elastike në përdorim . Material latex ,cilsore dhe me ngjyra te ndryshme . Duhet te jene jo alergjike per lekuren dhe te jene te pa depertueshme nga lengjet e ndryshme Të jenë të paketuara me ambalazhin e fabrikës ku dallohen qartë kodi i periudhesit dhe të dhënat teknike.

Doreza plastike te trasha- Doreza plastike te trasha, cilesore, per lageshtire dhe papasterti, me ngjyre. Të kenë qëndrueshmëri të fortë me material që nuk dëmtohet lehtë dhe elastik, shumë përdorimshe.

Fshesa merimange-fshese merimangash, me fije plastike te dendura dhe me shkop te gjate.

Kosh mesatar për mbeturina -per perdorim te brendeshen duhet te jete me kapacitet 15 Lt PVC, me diminsionet 38x30x31 cm , me hapje me pedal dhe ngjyra të ndryshme.

Kosh i madh plerash ,50 kg për perdorim te brendeshem duhet te njete me hapje me pedal dhe ngjyra te ndryshme .

Kosh për banjo -kosh mbeturinash për banjo material plastik , rezistende ndaj lagështirës.

Shkop me gome dhe sfungjer per larjen e xhamave me bisht zgjatues -te jete me hapje deri ne 1.5m, me bisht zgjatues metalik dhe te përdoret nga te dy anet.

Ilac pllakash -Solucion larës dyshemeje (pllakash) me arome te mirë ,ambalazhimi në shishe plastike 1-4 liter.

Furce për WC- Furca për pastrim WC , furca pastimi lavamani me fije plastike te forta per pastrimin e siperfaqeve te veshtira. Furcat te kene mbajtesen e saj (komplet).

Kaci (lopatë) plehrash plastike me bisht 1 meter - Kacia të jetë në formë kutie e hapur nga përpara për mbledhjen e papastërtive të ndryshme, e pajisur me një bisht te montueshëm dhe çmontueshëm.

Cizme- Cizme llastiku, masat sipas nevojave.

Klor me bidon- Zbardhues për pastrim solucion efikas ne heqjen e kriprave te depozituara si dhe papastertive.Ambalazhimi ne shishe plastike 1-4 litra.

Sapun i lengeshëm- Te jete cilesore. Tu jape duarve butesi dhe arome te kendeshme freskie. Te jete jo alergjik per lekuren , ambalazhim 1-4 litra . Etiketimi ne perputhje me rregulloren CE nr. 1272/2008 .te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit.

Sfungjera- Të jene nga njëra anë me fibër te forte arabizive për pastrim sipërfaqësh të ashpera dhe nga ana tjetër sfungjer me pore te vogla . Anësoret të jenë me kanal për mbrojtje te thonjeve. Ambalazhimi të jetë nga fabrika maksimumi 3-10 copë për pako.

Ilac për WC – Te jete leng, shume i perqendruar dhe me nje formule shume efikase ne heqjen e papastertise dhe njollave apo mikrobeve. Te mos mbaje arome te forte dhe mos te demtoje lekuren e njeriut. Te jete i lehte ne shpelarje me uje. Ambalazhimi ne shishe plastike 1-4 litra.

Sapun duarsh -sapun tualeti duarsh me peshë 115 gr,Sapun tualeti duarsh me pesh 155 gr. Të jetë

cilësor ,me aftësi shkumues të lartë .Paraqitja fizike te jete e ngushtë.

Letra per duart- Letra te thata per fshirjen e duarve me trashesi normale, te zakonshme.

Letra higjenike- Letër higjenike 10 rulonn te jete e trashe dhe asimilueshme nhga uje , Cilësia e lartë :Pure cululoze e shtres Minimalisht 150 metra Dimensionet e rulonit. 9.7x20(ose i perafert).

Qese te zeza - Qese plastike te zeza per kosha , rezistente, 70 Lt, pako me 10 cope qese.

Qese te zeza - Qese plastike te zeza per kosha te medhenj, rezistente, 100 Lt, pako me 10 cope qese.

Perparese per sanitare,te bardha- Perparese doku , te bardha, masat sipas nevojave (M, L, XL)

Pantofla per sanitaret - Pantofla prej materiali plastik, të sheshta dhe me taban që nuk rrëshket në lagështirë, masat sipas nevojave.

Aromatik kasetash banje - Aromatik tualeti, me efekt pastrimi dhe dezinfektimi. Të jetë aromatizues në formë sapuni të cilat vendosen brenda në kasetën e tualetit ose brenda në anën e WC-së. Paketimi të jetë në pako.

Aromatik per zyra spray - Deodorant ambienti me efekt aormatizues qe zgjat. Te mos jete i demshem. Produkti te jete i gatshem per perdorim. Te jete i konfeksionuar ne bombel alumini me mekanizem sprucimi me kapacitet 250-300 ml. Të jetë me aromë të këndshme.

Kosha inoksi plehra/cigaresh - Kosha inoksi plehra/cigaresh per ambiente te jashtme.

Lecka te medha per koridoret- Leckë pastrimi pllakash me bisht. Të jetë me formë drejtkëndore, e përbërë nga fibra tekstili të buta që thithin ujin shumë mirë me material mikrofibër. Të këtë aftësi të heq nivelet më të larta të papastërtive. Dendësia e leckës të jetë jo më e vogël se 160 gr. Të ketë qëndrueshmëri. Gjatësia e leckës të jete jo me e vogël se 40 cm.

Kosha plehrash cilesor metalik mat per zyra - Kosha plehrash cilesor metalik mat per zyra.

Shpatulla kruajtese- Shpatulla kruajtese metalike per heqjen e mbeturinave ngjitese ne dysheme.

Kanace plastike - Kanaçe plastike të masës 500 - 1000 ml me dorezë

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi

sipas shkresës Nr.5087/2 Prot, date 02.10.2023, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

NJËSIA E PROKURIMIT